

## BIBLIOTEKAT E MEDRESEVE DHE MYFTINIVE ORAKUJ QË BËNIN DRITË

Bibliotekat e medreseve dhe myftinive u bënë kaq të famshme sa nisën të vizitoheshin edhe nga udhëtarë, shkrimtarë dhe studiues të huaj. Ato ishin nga më të mirat, pasuroheshin vazhdimisht. Njerëzit e pasur u dhuronin libra dhe relikte të çmueshme. Kërshëria për librin ishte e madhe, dëshironin të dinin për kohët e shkuara dhe të ardhmen e tyre. Te librat gjendeshin të fshehta të mëdha. Në bibliotekë ruheshin edhe akte të Gjykatës së Shenjtë (sherie), regjistra kadastralë e dokumente të tjera të moçme. Edhe familjet e mëdha myslimane krijuan bibliotekat e tyre, por libra gjeje kudo në familjet myslimane. Biblioteka e Bushatllinjve, e Vlorajve, e Frashërllinjve, e Bahollit dhe shumë të tjera ishin thesare të vërteta. Vlerësimi për to ishte i madh. E veçantë mbeti biblioteka e Myftiut të Tabakëve të Shkodrës, ose siç quhej ndryshe e “Klyçit”. Ajo u shndërrua në një orakull të vërtetë për vendasit dhe të huajt. Gjermanët u bënë frekuentuesit e saj të përhershëm. Vinin aty për të pyetur për luftën dhe paqen, tregtinë dhe trazirat e papritura që mund të lindnin mes popujve etj. Për të gjitha këto do të flasim më poshtë, sepse, fillimisht, na duhet të bëjmë një hyrje të shkurtër për xhamitë dhe shkollat që ngriheshin pranë tyre, të cilat aftësonin besimtarët për të kuptuar botën.

### Shkollimi

Aty ku ngrihej një xhami, ndërtohej edhe një shkollë fillore (mejtep), ose një shkollë e mesme (medrese), ku besimtarët myslimanë arsimoheshin. Shkollat drejtoheshin prej imamëve. Punën e mësuesit e bënë klerikët e caktuar për këtë qëllim. Në shkollë, shpesh, mësonin bashkë vajza dhe djem. Moshë e pranimit ishte nga 7 vjeç deri në 16-të, por nuk refuzoheshin as të rriturit, pavarësisht nga mosha që kishin. Shkolla mbante dyert hapur për çdo njeri që kishte dëshirë të studionte. Shpjegimi i mësimëve bëhej në gjuhën shqipe.

Shpjegim më të plotë mbi shkollat e xhamive jep dr. Ramiz Zekaj, te studimi i tij “Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX”, ku shkruan:

*“Lëndët që zhvilloheshin në mejtepe ishin të karakterit teologjik islam, duke përdorur terminologji të konsiderueshme edhe në gjuhën arabe, ndërsa shpjegimet bëheshin në gjuhën amtare shqipe. Pjesën më të madhe të kohës së mësimit në këto shkolla e zinte mësimi i Kuranit dhe komentimi i tij që bëhej në gjuhën shqipe. Paralelisht me këto, nxënësve u mësoheshin edhe elementet e para të aritmetikës. Sipas rastit, në disa mejtepe zhvilloheshin edhe lëndë të tjera. Ky cikël i ulët i arsimit islamik normalisht zgjaste 3 vjet dhe ndryshe quhej edhe “Ruzhdie”, kurse ato të karakterit të shkollës fillore quheshin “Ibtidaije”.<sup>(1)</sup>*

Kështu ndodhi edhe në qytetin e Korçës. Themelimi i qytetit nisi me ndërtimin e Xhamisë së Madhe që besimtarët myslimanë të kishin ku të faleshin. Iljaz bej Mirahori, themeluesi i qytetit të Korçës, flet me nderim si për besimtarët meshkuj ashtu edhe për besimtare femra. Kjo gjë vihet re edhe në dekretin perandorak të vitit 1504-1505, ku përmenden si besimtarët myslimanë ashtu edhe besimtare myslimane. Më konkretisht në këtë dekret thuhet:

*“...Mirahori ngriti e ndërtoi një faltore të shenjtë, të cilën e la vakëf për gjithë ata myslimanë e myslimane që duan të falin në të çdo falje”.<sup>(2)</sup>*

### Medreseja e Korçës për vajza dhe djem

Krahas Xhamisë së Madhe, ndërtimi i së cilës zgjati 10 vjet (1486-1496), u ndërtua edhe shkolla e vajzave dhe djemve. Nga dekreti i përmendur më sipër, citojmë:

*“Mirahori ngriti e ndërtoi pastaj... një shkollë të bukur e të hijshme. Pastaj caktoi këtë si vakëf për gjithë ata djem dhe vajza myslimane që vazhdojnë të mësojnë këndimin e Kuranit e të studiojnë dituri të tjera”.<sup>(3)</sup>*

<sup>1</sup> Dr. Ramiz Zekaj, kreu II, Arsimit islamik shqip në trevat shqiptare.

<sup>2</sup> Pjesë nga dekreti perandorak, kthimi i pronave të Mirahorit në vakëfe.

<sup>3</sup> Pjesë nga dekreti perandorak, kthimi i pronave të Mirahorit në vakëfe.

Edhe në medresenë e Korçës shpjegimi i mësimeve bëhej në gjuhën shqipe. Përgatitja e vajzave për punët e dorës dhe si të bëheshin nëna të mira bëhej vetëm në shqip. Mosha për të shkuar në medrese ishte e pakufizuar, madje për familjarët (prindërit-studentë) që shkonin në shkollë, xhamia siguronte falas ushqimin e fëmijëve:

*“Vakëflënësi i lartpërmendur vë si kusht që në këtë Imaret të gatuhet e të furnizohet çdo ditë dy herë ushqim, në drekë e në darkë. Do të gatuhet çorbë gruri dhe orizi etj. dhe do të hajë kushdo që të jetë i pranishëm në kohë të bukës, i vobektë, pasanik, i varfër, i huaj, udhëtar e banues, fëmijët e studentëve etj. Kushdo qoftë, çfarëdo që të hanë, e kanë hallall dhe u bëftë mirë!”<sup>(4)</sup>*

### **Biblioteka e medresesë së Korçës**

Mirahori tregoi kujdes të veçantë edhe për ngritjen e një biblioteke pranë xhamisë. Një bibliotekë të tillë kishte ndërtuar edhe pranë xhamisë së Stambollit, e cila quhej xhild-hane: Tek vakëfnameja thuhet:

*“Edhe për shehun e dervishët e tij që banojnë në dhomat e quajtura xhildë-hane e që janë përballë xhamisë në fjalë, cakton 20 derhem për çdo ditë...”<sup>(5)</sup>*

Sipas Mytevelinjve, pasardhës të Mirahorëve, xhild-hanet (bibliotekat) ishin, zakonisht, pjesë e xhamive, ku përveç librave të fesë, mbaheshin edhe librat më të mirë të kohës. Një bibliotekë të tillë pati edhe xhamia e Korçës, e cila u vinte në ndihmë vajzave dhe djemve të medresesë, dhe gjithkujt tjetër që donte të lexonte. Biblioteka e xhamisë së Korçës ose e medresesë ndihmoi shumë në nxitjen e interesit për librin. Francezi August Dozon gjatë vizitës së tij në Korçë, më 1874-n, ndër të tjera i shkruante qeverisë së tij:

*“Po bëhen përgatitje për të ngritur një tipografi ku do të bëhen botime të autorëve klasikë”,*

gjë që tregon se banorët e qytetit të Korçës kishin qenë prej shekujsh të miqësuar me librin.

<sup>4</sup> Pjesë nga dekreti perandorak, kthimi i pronave të Mirahorit në vakëfe.

<sup>5</sup> Pjesë nga dekreti perandorak, kthimi i pronave të Mirahorit në vakëfe.

Kjo është dhe arsyeja pse fill pas botimit të gazetës “Albania” të Faik Konicës, mjaft banorë të qytetit të Korçës u bënë abonentë të kësaj gazete: *“Ky vit është i bekuar ndër gjithë të tjerët për kombin shqiptar. Fara që mbuallëm dy vjet më parë, zuri të sjellë pemët e saj. Më të katër anët shohim fletore, bibla të reja, shoqëri kombiare, që po krehen (dalin). ...Albania hyn tani pothuajse lirshëm në Shqipëri. Në Korçë, gjer në fund të gushtit, Albania këndohej në kafenetë...”*.<sup>(6)</sup>

Duket që Korça nuk bënte dot pa librin dhe gazetën. Në vitin 1908, Sami bej Pojani, botoi në Korçë gazetën “Korça”, të parën gazetë shqiptare në Shqipëri dhe ngriti shtypshkronjën për shtypjen e gazetave, revistave, librave etj. Në këtë kohë edhe klubi “Dituria shqip”, e kryesuar nga Orhan Pojani, krijoi një bibliotekë të madhe, mjaft të pasur me libra dhe gazeta, e cila frekuentohej nga një numër i madh njerëzish. Librat e kësaj biblioteke dhe të medresesë u dogjën prej andartëve grekë në qershor të vitit 1914. Në këtë kohë u vodh edhe mbulesa prej plumbi e tri kubeve të jashtme të Xhamisë së Madhe.

### **Biblioteka e Myftinisë së Korçës**

Djegia e librave të bibliotekës së medresesë për besimtarët myslimanë të Korçës mbeti dhimbje e paharrueshme. Prisinin çastin më të volitshëm për ta ringritur sërish, por vitet e luftës nuk i lejuan për një kohë të gjatë. Biblioteka, fillimisht, mund të ngrihej pa shpenzime të mëdha, pasi libra gjendeshin në çdo familje myslimanëve të Korçës. Ishin të shumtë edhe ata që dinin një gjuhë të huaj. Megjithatë në vitin 1942, edhe pse vendi ishte i pushtuar, besimtarët morën vendim për ngritjen e bibliotekës së Myftinisë, e cila do t’u shërbente edhe vajzave, edhe djemve të medresesë.

Myftiu i Korçës në nja takim me besimtarët u kërkoi të bëhej realitet vendimi që kishin marrë:

*“Patëm vendosur formimin e një biblioteke fetaro-morale, posaçërisht në një dhomë të kësaj kryemyftinie, dëshirojmë të tregojmë një qenmënie diturie e kulturele tue mbledhur çdo libër në këtë bibliotekë; është e ditur se nëpër dollapet e*

<sup>6</sup> Gazeta “Albania” 1898, nr 10, f. 153

*shtëpive kemi secili pak a shumë libra të cilat të jenë lënë në harresë tue mos përfituar nga ato, (pasi nga anëtarët e familjes janë të lexuara). Më pëlqen ta falënderoj që tash secilin qoftë, që të ketë këtë mirësinë të dhurojë në këtë biblioteke ato libra të ndodhura të çdo gjuhe qofshin, po ashtu dëshirojmë që bashkë me librat të na dërgonet dhe fotografia e dhuruesit për të zënë vend nderimi në atë dhomë. Biblioteka do të jetë e celun ngahera dhe e quajmë detyrë t'i përgjigjemi secilit që të na drejtonet për ndonjë pyetje a problem fetar. Lusim Zotin e madh të na ndihmojë e të na bekojë gjithmonë.*

4 tetor 1942

*Kryemyftiu i zonës së Korçës, Hafiz Xhafer Aliu”.*<sup>(7)</sup>

### **Arkivi i Myftinisë Berat**

Tashmë po ndalemi te arkivi i Myftinisë së Beratit dhe biblioteka e sheh Hasanit të Beratit, për të cilat ka shumë pak informacion:

*“Myftinia e Beratit ka patur një arkiv të moçëm në gjuhën turke ku gjendeshin gjithë aktet e Gjykatores së Shenjtë (sherie), regjistrat kadastralë të moçme dhe shumë sende të tjera interesante për historinë e qytetit, dorëshkrime të ndryshme në arabisht e persisht dhe koleksione kuranesh.”*<sup>(8)</sup>

### **Biblioteka e sheh Hasanit**

*“Teqeja e të mirit Sheh Hasanit ka patur shumë libra e dorëshkrime në gjuhët orientale (arabisht, persisht dhe turqisht), dhe dokumente të tjera që nga librat, dhe dorëshkrimet, dhe kishte shumë dokumente prej atyre që ishin të vlefshme për historinë e qytetit dhe të kombit tonë – fatkeqësisht kjo bibliotekë u dogj e gjitha në kohë të kryengritjes së rebelëve në vitin 1914. Thuhet se aty gjendej edhe dorëshkrimi i shkruar shqipe me gërma arabe i Nesim bej Përmetit që bën fjalë historia e literaturës shqipe.”*<sup>(9)</sup>

<sup>7</sup> Kultura islame 1942-1943, nr.1-2, f.38

<sup>8</sup> Hylli i dritës 1938, nr. 6, f. 290

<sup>9</sup> Hylli i dritës 1938, nr. 6, f. 290

## Biblioteka e Myftiut të Tabakëve ose biblioteka e Kllyçit<sup>10</sup>

Në vitet '30, në të hyrë të Shkodrës, jo larg Xhamisë së Plumbit, gjendej një bibliotekë me libra të shumtë e dorëshkrime të rralla, të lidhura bukur, me kapakë të trashë dhe zbukurime prej ari. Ajo ndodhej në një nga lagjet më të vjetra të Shkodrës, në Lagjen e Tabakëve, që ishte pronë e myftiut Isuf Tabaku. Edhe udha që të çonte te biblioteka quhej "Udha e myftiut". Isuf Tabaku ishte njeri i studiuar, me dije të mëdha, lexonte shumë, i pëlqente të shkruante dhe dinte të bënte kritikën e librave. Ishte njeri i zgjuar, i vlerësuar prej njerëzve, madje kishte aftësinë të bënte parashikime dhe të mos ishte i gabuar. Në të vërtetë, më shumë se parashikime, ato ishin këshilla të vlefshme, që askush nuk i refuzonte. Kjo ishte dhe arsyeja që ai u bë mjaft i njohur. Biblioteka e tij nisi të vizitohet edhe nga njerëz që vinin nga vende të largëta të botës. Dëshironin ta pyesnin për punët e tregtisë, për luftërat, paqen, për mbretërit e gjithçka tjetër. Biblioteka e tij u bë e famshme.

### Historiku i bibliotekës

Por, në të vërtetë, biblioteka ishte themeluar që nga viti 1750 prej kadiut (gjyqtarit) të Shkodrës, Hasan efendi Kllyçi. I nxitur prej dëshirës për të qenë gjyqtar i drejtë dhe i ndershëm, iu përkushtua leximit të librave. Numri i librave në shtëpinë e tij u bë i madh. Kështu u krijua biblioteka me emrin "Kllyçi". Më pas, Hasan efendi Kllyçi ia dhuroi bibliotekën nipit të tij, Isuf Tabakut, i cili ia rriti edhe më tepër famën dhe madhësitinë. Një pjesë të librave, Isuf Tabaku, i kishte lexuar që kur ishte i vogël, kurse tani ishte pronar i tyre.

Në fillimet e veta biblioteka ndodhej në Kala, por për shkak të një zjarri, u dogj gjithçka. Ngjarja ka mbetur e fiksuar në librin (dorëshkrim) të Isuf Tabakut, ku thuhet:

*"Data 1290, në këtë vjet, më 8 të muejit qanuni evvel<sup>(10)</sup>, ditën e diel në orën 3 allaturka, xhebehana që u gjend në kala të Shkodrës mori flakë nga një rrufe e mndershme. Me të ndezun të municionit u ba zhari krejtësisht edhe shtëpija e jeme, mbrenda së cilës maroj gjithshka. Un dhe djali i jem*

<sup>10</sup> Viti 1874, sipas kalendarit të sotëm, shënimi ynë - V.H.

*pështume; 5 vetë tjerë sharruen zhar në atë zjerm. Gëzofshin paqin e Zotit! Bashkë me teshat e shtëpisë e shumta e librave më maruen. I madhi Zot ma shpërbleftë në kohën që shpërblehen të tana punët.”<sup>(11)</sup>*

Që nga kjo kohë, shtëpia e Isuf Tabakut dhe biblioteka u transferuan pranë Xhamisë së Plumbit. Një vit më pas, Tabaku u emërua myfti. Që nga ajo ditë emri i tij nisi të bëhej gjithnjë e më i respektuar. Vetëm me vendosjen e diktaturës u bënë përpjekje që emri i tij të harrohej, por këngët që iu kënduan këtij njeriu të madh e të ditur ishin të shumta. Thuhet se ato këngë këndohen edhe sot e kësaj dite. Ka të tjerë që mbajnë mend edhe parashikimet e famshme të tij. Te biblioteka e myftiut vinin njerëz nga veriu dhe jugu. Mbretërit dërgonin emisarë për të mësuar mbi fatin e vendit dhe jetën e tyre. Vizitat bëheshin më të shpeshta sa herë që bota gjendej në udhëkryqe. Ata që nuk kishin mundësi të udhëtonin, dërgonin letra. Edhe përgjigjen e merrnin me letër.

### **Gjermanët frekuentues të bibliotekës**

Frekuentues të rregullt të bibliotekës së Myftiut të Tabakëve të Shkodrës u bënë edhe gjermanët. Nuk kishte turist gjerman që të vinte në Shkodër dhe të mos kthehej te selia e orakullit. Pyesnin për gjithçka, ndoshta përpiqeshin të kuptonin ku qëndronte zotësia e myftiut Isuf Tabaku që ishte bërë kaq i famshëm e i njohur në shumë vende të botës, çfarë misteri fshihej tek ajo bibliotekë. Sipas dr. Filip Fishtës, gjermanët, pasi njiheshin me Xhaminë e Plumbit, vizitonin edhe bibliotekën. Madje, Fishta porosiste të shkruhej çdo gjë që ndodhte apo kishte ndodhur në bibliotekën e myftiut, pasi bëhej fjalë për ngjarje që dilnin mbi kohën. Ato ishin të jashtëzakonshme. Në bibliotekë gjithçka ishte vendosur sipas një rregulli të caktuar, ku çdo libër gjendej në çast pa asnjë vështirësi.

Sipas z. Gjovalin Çunit, drejtor i bibliotekës publike në Shkodër “Marin Barleti”, intervistuar prej Arben Hallunit:

*“Biblioteka e Myftisë së Tabakëve” apo siç njihet edhe ndryshe biblioteka “Këllyçi” shquhet edhe për organizimin e saj. Krahas inventarizimit, biblioteka përdori dhe lloje të*

<sup>11</sup> Kultura islame 1941-1942, nr. 1-2, f. 61.

*ndryshme klasifikimi lëndor. Në bibliotekën “Këllyçi” të gjithë librat ishin të ndara në 27 lëndë dhe për lehtësi të përdoruesit biblioteka “Këllyçi” zotëronte një skedar alfabetik dhe një skedar kronologjik. Numri i librave që ndodhej në bibliotekë dhe kryesisht dorëshkrime është diku tek 1900, ndërsa tek dorëshkrimet janë 200 copë”.*

### **Stambolli kërkonte këshilla**

Për këtë bibliotekë ka shkruar edhe dr. Taullah Shkreli, profesor i liceut shtetëror të Shkodrës. Sipas Shkrelit, në bibliotekë gjendeshin dorëshkrime shqipe, të shkruara me alfabetin e vjetër turqisht. Emri i Myftiut të Tabakëve të Shkodrës u bë i njohur edhe në rangjet më të larta të perandorisë: Ja çfarë shkruan dr. Filip Fishta në një artikull të revistës “Përpjekja shqiptare”:

*“Stambolli i drejtohej për këshilla Myftisë së Tabakëve, sa herë që e shifte nevojën në lidhje me çashtje problematike që i paraqiteshin n’interpretimn e sa problemave me besimtarët. Populli i jonë ende sot e kujton emnin e Myftisë së Tabakëve, vdekë para një shekulli. Populli i qytetit të Shkodrës shton se, i pyetur ky myfti, “u epete fetfa” shumë çështjeve të shumëllojshme”.*<sup>(12)</sup>

Filip Fishta jep edhe një informacion tjetër:

*“Shtëpia ku ndodhet kjo Bibliothekë, asht një nga ato tipiket në qytetin e Shkodrës: me oborr të madh para shtëpisë; një shtëpi e vjetër dykatëshe. Pranë çardakut dhe odës së miqve, ndodhej dhoma tjetër e librave”.*

Aty Fishta u njoh për herë të parë me bibliotekën e famshme: botimet dhe dorëshkrimet zinin tri faqet e mureve. Ishte e vështirë që në pak kohë të krijoje një ide të qartë çfarë vlerash ruheshin në atë shtëpi, por edhe një shikim i vetëm të emociononte me gjërat e rralla që gjendeshin aty.

*“Librat e shtypun si edhe dorëshkrimet, gjithsej afër tri mij blejsh, – shkruan Fishta, – ishin të mbajtur përgjithsisht mirë,*

<sup>12</sup> Përpjekja shqiptare 1939, nr. 25-27, f. 64

*gati të gjithë të lidhun në kartuç. Disa nga dorëshkrimet ishin shkruem prej një kaligrafie t'ushtruem, që i kujtonin njeriut disa nga dorëshkrimet e bibliotekave të mëdha t'Europës Perëndimore”.*

### **Tregtarët pyesnin për tregtinë**

Biblioteka e Myftiut të Tabakëve të Shkodrës mbeti gjithnjë e frekuentuar, ajo kishte mysafirë të përhershëm edhe nga tregtarët vendas. Ata dëshironin të dinin si do të ishte tregu, pas një ngjarjeje të bujshme, pas një kërcënimi që ishte shfaqur në horizont apo kur botën e prisnin të papritura. Lef Nosi, koleksionisti i njohur, mes dokumenteve të shumta, ruante edhe një letër të Myftinisë së Tabakëve drejtuar Myftinisë së Elbasanit në lidhje me këshillat që do t'u jepeshin tregtarëve të vendit për atë mot, gjë që na tregon se Myftinia e Shkodrës kish fituar emër të madh.

Përshkrimin e librave të bibliotekës së myftiut e gjejmë sërish te Filip Fishta:

*“Ndonji herë në fletën e parë apo gjatë tekstit ndër fletët e ndryshme, si asht zakon ndër dorëshkrimet e vjetra vrehet nga një punim vizatimi me ngjyra: arabeskime shumëllojësh mbi një shesh ari. Këto lloje dorëshkrimesh edhe nga pikëpamja e artit të vizatimit duhet të tërheqin vërejtjen tonë: duhet t'i ruajmë me kujdesin ma të madh edhe të mos i lëshojmë ndër duart e fëmijëve”.<sup>(13)</sup>*

Veç të tjerash biblioteka kishte edhe një dorëshkrim “Vehibije” në dialektin kosovar, shkruar nga Tahir efendi Gjakova, nën emrin Tahir Efendi i Madh; libra të kopjuar me dorë nga Isuf Tabaku; një libër (dorëshkrim) të tij, i hartuar si jetëshkrim, ku përshkruhen ngjarje të ndryshme historike, autobiografi të shkrimtarëve, mbresat për librat e lexuar, qëndrimin kritik që mban vetë Isufi ndaj librave etj. Mes dorëshkrimeve të tjera ruheshin edhe dy traktatet astronomike të Hoxha Tahsimit, botuar në Paris, më 1884, edhe një “Abc” shqipe, botuar në Stamboll në vitin 1900. Më pas biblioteka kaloi në dorën e Esad Myftiut, pasardhës i Isuf Tabakut.

<sup>13</sup> Prof. Filip Fishta, Përpjekja shqiptare 1939, nr. 25-27, f. 64.

## Biblioteka e Vakëfit të Shkodrës ose biblioteka e Bushatllinjve

Shkodra pati disa xhami, më e madhja kishte 50 dhoma. Si qendër vilajeti dhe kryemyftinie, Shkodra përfshinte rrethet Ulqin, Tivar, Podgoricë, Krujë e deri në Tiranë. Pati shkolla fetare për besimtarët, (mejtepe dhe dy medrese); njëra prej tyre ishte medrese e lartë, ngrihej nën kala, aty mësoheshin gjuhët klasike orientale arabisht e persisht, matematikë, kimi, histori, letërsi, retorikë e lëndë të tjera, kurse tjetra ndodhej në brendësi të pazarit. Medresetë u pajisën me biblioteka, (qytyp-hane), ose siç quheshin ndryshe, “shtëpitë e librave”, që kishin dhe konvikt për nxënësit. Ndërtesat e dy medreseve ishin të mëdha me shumë dhoma. Dy mësonjësit e parë të medreseve kishin qenë Krimilia dhe Qilisia. Pas tyre erdhën mësuesit shqiptarë, ku njeri prej tyre ishte Myrteza Efendiu.

### Historiku i bibliotekës

Iniciator për krijimin e bibliotekës u bë Mehmed pashë Bushatlliu, krijuesi i Pashallëkut të Shkodrës, pasha gjatë viteve 1768–1774, i njohur ndryshe si Mehmet Pashë Palaku. Ky titull iu dha sepse ishte Shejhu Sufi i Esnafit të terzinjve të Shkodrës. Biblioteka e tij i kaloi të birit, Mustafa Pashë Bushatlliut. Ky i fundit, pas vdekjes së tij, më 1860, me dëshirën e vet, bibliotekën dhe shtëpinë ia dhuroi vakëfit, për t’u ardhur në ndihmë të rinjve që studionin dhe gjithkujt tjetër. Shtëpia e Mustafa Pashës ishte e madhe, me 12 dhoma e pamje madhështore. Shtrihej në një sipërfaqe të madhe, gjë që e bënte ndërtesën të dukej hijerëndë. Biblioteka e Bushatllinjve pati mijëra volume: libra dhe dorëshkrime të shkruara në arabisht, persisht, turqisht, frëngjisht, në gjuhë të tjera dhe shqip. Në ato kohë kishte shumë kuriozitet për librat: *“Më përpara (biblioteka e Vakëfit) ka qenë shumë e dobishme. Librat e saj kanë shkuar në dorë të shumëkujt. Edhe sot gjenden listat e marrësve të librave në disa deftera të mëdha ba apostafat për këtë gjë. Librat janë me vula të pashallarëve, ndër to asht dhe vula e Kara Mahmutit dhe sidomos gjinden vula të Mustafa Pashës. Nga kjo kuptojmë kohën e të pasunuemit të bibliotekës me këto libra”*.<sup>(14)</sup>

<sup>14</sup> Kultura islame 1941-1942, nr. 1-2, f. 63

## Shërbeu si bibliotekë popullore

Biblioteka trashëgoi edhe fondin e librave të Medresesë së Vjetër që ndodhej në Pazar. Librat mbaheshin në dy-tri kopje, pasi shërbeu si bibliotekë popullore. Mes autorëve të huaj ishin të pranishme veprat e Saadi Shirazi-it, Xhelaledin Muhamed Rumit, Hafiz Shirazit, filozofit El-Farabiu, të Ibën Sinas i njohur në perëndim me emrin "Avicena", të Ibën Rushdit, i mbiquajtur (Averroës) nga Kordoba, të cilët me punën e tyre, analizat dhe komentet e shkëlqyera e bënë të kuptueshme dhe akoma më cilësore filozofinë e Aristotelit dhe të shumë autorëve të tjerë, ndërsa në gjuhën shqipe përveç letërsisë, gjendeshin libra teologjie, historie, filozofie, matematike, kimie dhe botime të tjera.

*"Këto biblioteka, ashtu si dhe biblioteka "Këllyçi" tërhoqën vëmendjen e vizitorëve të huaj dhe studiuesve të bibliotekave orientale, mes të cilëve dhe të anglezit Urkuard, i cili na ka lënë shënime për këtë bibliotekë që thotë: "Mustafa Bushatliuka qënë një njeri serioz dhe kishte mëkëmbë një bibliotekë me libra në frëngjisht, në turqisht, të cilat më së fundi ia fali vakëfit".<sup>(15)</sup>*

Më vonë biblioteka u transferua në zyrën e Kryemyftinisë.

## Biblioteka e Medresesë së Përgjithshme të Tiranës

Medreseja e Përgjithshme e Tiranës që nga dita e krijimit të saj luajti një rol të veçantë në përgatitjen e profesionistëve të fushave të ndryshme, si inxhinierë, mjekë, mësues, historianë, gjuhëtarë etj. Nxënësit dhe studentët e saj vinin nga të gjitha rrethet e vendit dhe kjo bëri të mundur që ata të kontribuonin në vendlindjet e tyre. Medreseja u çel në mars të vitit 1924 nën kujdesin e Këshillit të Naltë të Sheriatit Islam, me kryetar Vehbi Dibrën. Ajo përfshiu tri kategoritë e sistemit arsimor: fillor, lice dhe universitet. Përparimi i saj që i shpejtë dhe në vitin 1929 mori emrin "Medreseja e Përgjithshme", në vitin 1931 hyri në godinën e re, në vitin 1932 u dhanë diplomat e para, ndërsa në vitin 1936 pati 125 nxënës. Gjatë gjithë jetës së saj i shërbeu vendit me devotshmëri, por fatkeqësisht, në vitin 1964 medreseja u mbyll nga diktatura, për t'u riçelur sërish në vitin 1991.

---

<sup>15</sup> Sipas z. Gjovalin Çuni, drejtor i bibliotekës publike "Marin Barleti" në Shkodër.

Në vitin 1932 u pajis me bibliotekë. Që në fillesat e saj "... veç librave të botuara nga Këshilli i Lartë i Komitetit Muhamedan, koleksioneve të revistës "Zani i Naltë", botimeve prej klerikëve Muhamedanë, kishte edhe 1000 copë libra të tjera të ndryshme në gjuhët arabike, persiane, engleze dhe franceze, që shumë prej të cilave ishin dhuratë e shoqërive të studentëve myslimanë të Hindisë, Egjiptit e gjetkë. Biblioteka ishte na pasurim të vazhdueshëm me qëllim që kjo të ishte vlefshme për profesoret, studiuesit, studentët, klerikët, besimtarët dhe për këdo tjetër.<sup>(16)</sup>

Për rritjen e cilësisë dhe të njohurive të nxënësve, i shtoi vitet e studimit edhe me dy vjet të tjera: "Sipas nevojave të konstatueme nga Kryesia e Komunitetit Mysliman dhe Drejtoria e Medresesë së Përgjithshme, pamë si nevojë që koha e studimit në Medresenë e Përgjithshme në Tiranë të shtohet edhe dy vjet, d.m.th. medreseja të ketë nandë vjet studimi. ...Për këtë arsye Komuniteti Mysliman në vitin 1939, me vërtetimin e Këshillit të Përgjithshëm pat aprovue zbatimin e programit nand-vjeçar dhe për herë të parë në vitin mësimor 1942-43 dhanë maturën studentët e klasës së IX".<sup>(17)</sup>

### **Bibliotekat e medreseve dhe myftinive dëshirë e përhershme**

Bibliotekat e medreseve dhe myftinive ishin një dëshirë e përhershme e besimtarëve myslimanë. Me kalimin e viteve numri i myslimanëve bëhej gjithnjë e më i madh, po kështu edhe dëshira e tyre për të pasur një sallon modern të librit bëhej edhe më e madhe. E tillë vijon të mbetet edhe sot e kësaj dite. Ja çfarë parashikonte komuniteti mysliman në vitin 1944-1945:

*"Detyra e parë e Komunitetit Mysliman asht të ngrejë një faltore të madhe modern në Qendër, e cila, në raste festash kombëtare ose fetare, të marrë 10-15 mijë persona. Këtu nuk po flasim për një faltore kolosale si ato të shumë vendeve të jashtme myslimane, që nxënë mbase 50-60 mijë njerëz, por së paku të plotësojë nevojën urgjente të elementit mysliman në kryeqytet.*

Ajo lypset të ketë një sallon të mirë studimi, ku të themelohet një bibliotekë e pasun nër vepra të vlefshme të çdo gjuhe qofshin e

<sup>16</sup> Referuar revistës "Hylli i dritës" 1940, nr.1-2, f. 58-59

<sup>17</sup> Revista "Kultura islame" 1942-1943, f. 220

sidomos në shqip. Aty të gjinden gazeta e revista të çdo lloji, kështu që lexuesi të mund të marrë njohuri të përgjithshme mbi botën e gjanë e veçanërisht mbi atë Islame. Veprat, ose të përkohshmet që do të mblidhen, të jenë në tri-katër kopje (ekzemplarë), që në këtë mënyrë t'u epen hua abonistave për t'i këndue nër shtëpitë e veta brenda një afati të caktuem, por gjithmonë tue ruejt një kopje për lexuesin që don me e këndue në vend.

Në këtë mes duhet medoemos të caktohet një vend i posaçëm për femrat, pse pa kultivimin e tyne do të ishte e pamundun zhdukja e shumë zakoneve që na kanë ngelur trashëgim nga të huajt. Ato, tue ndigjue këshilla të vlefshme në këtë xhami, fare lehtë mund t'i largojnë burrat, djemtë e vajzat e tyne nga shumë vese e punë të mbrapshta. Në një xhami kësodore duhet të caktohen persona fetarë me kulturë të shëndoshë e sidomos të rinj që janë pajisun me shkencat modern të shekullit të sotshëm për të dhanë fjalime".<sup>(18)</sup>

Nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Fuqia e librit vlerësohej dhe ata që ishin shokë të tij, nuk u zhgënjyen kurrë: "Që kur Aliferi lexoi për herë të parë Plutarkun, që kur Schilleri njohu dramat e Shakespearë-it, që kur Giboni thithi volumin e parë të Historisë së Përgjithshme, po them, që në atë ditë, çdo njëri prej tyre e ndjeu veten të frymëzuar dhe secilit iu duk pak a shumë, se e fillonte vetëm atëherë qenien e vërtetë. La Fontaine, në moshën e re nuk ishte tjetër veçse një djalosh rrugësh, por kur dëgjoi një ode të kënduar nga Malherbe, bërtiti menjëherë: "Edhe unë jam poet!" dhe gjenia e tij u zgjua".<sup>(19)</sup>

<sup>18</sup> Kultura islame 1944-1945, nr. 9, f. 119-120

<sup>19</sup> Kultura islame 1940-1941, nr. 17-19, f. 142